



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE

Data: 15.10.2024

Nr: 22

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**PRANIMIN PËR SHOYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 13, DATË 11.10.2024 TË
DEPOZITUAR NGA Z. ASTRIT FADIL KAZIU**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 15.10.2024, me pjesëmarrjen e:

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Illirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Z. Astrit Fadil Kaziu

OBJEKT: Kundërshtim i vendimit nr. 181, datë 08.10.2024 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për plotësimin e vakancës së krijuar në Këshillin Bashkiak Peqin, nga mandati i ndërprerë i këshilltarit zj. Anxhela Tabaku me zj. Donika Ded Karina e cila në listën shumëemërore të kandidatëve për anëtar këshilli të subjektit zgjedhor Partia Socialiste të Shqipërisë mban numrin 13 (trembëdhjetë)

BAZË LIGJORE: Nenet 12/5, 7, neni 21, pika 1 shkronja “b”, të Kodit Zgjedhor.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

Data: 15.10.2024 Nr: 22
Ora: 12:00



“Për pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 13, datë 11.10.2024 të depozituar nga z. Astrit Fadil Kaziu”

VËREN:

Z. Astrit Fadil Kaziu ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kritereve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 13 regj., datë 11.10.2024.

Në mbledhjen e datës 15.10.2024, pas relatimit të z. Elvis Çefa u konstatua se kërkesa ankimore nr. 13, i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të Kodit Zgjedhor dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 13, datë 11.10.2024, të paraqitur nga z. Astrit Fadil Kaziu.
2. Kërkesa ankimore do të shqyrtohet në seancën e datës 17.10.2024, ora 11:00.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit në themel, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar